



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**UDHËZUESI PËR MBARËVAJTJEN E PROVIMIT ME SHKRIM**

- Nëse kandidati nuk paraqitet në kohën e caktuar për provim ose nëse para fillimit të provimit deklaron se heq dorë, konsiderohet se ai nuk iu ka nënshtruar provimit.
- Kandidati i cili heq dorë pasi që të ketë filluar provimin, konsiderohet se ka rënë nga provimi.
- Në vendin ku mbahet provimi, kandidatët duhet të ulen në vendin e caktuar nga mbikëqyrësi i sallës. Kandidatët të cilët vijnë në provim pas mbylljes së derës së sallës, nuk do të lejohen të hyjnë në provim.
- Kandidatët para hyrjes në sallë janë të obliguar të largojnë të gjitha gjërat personale, përveç dokumentit të identifikimit me fotografi të cilin duhet ta mbajnë me vete gjatë tërë kohës.
- Nuk lejohet përdorimi i telefonave mobil, llaptopit, dëgjuese/ kufjeve, aparat MP3, apo pajisjeve tjetra elektronike.
- Provimi me shkrim zgjat (2) dy orë. Gjatë provimit, kandidatit nuk i lejohet të ketë afër vetes asgjë përveç testit, fjalorit dhe stilolapsit. Shkelja e kësaj rregulle do të rezultojë me shpalljen e provimit si të pavlefshëm dhe diskualifikimin e kandidatit nga provimi.
- KGJK do të ofrojë letër, stilolapsa dhe materialet apo pajisjet e nevojshme për mbajtjen e provimit.
- Kur fillon provimi, të gjitha bisedat e kandidatëve ndërpriten dhe mbikëqyrësi i sallës lexon udhëzimet e provimit. Pas kësaj, mbikëqyrësi i sallës mund t'i përgjigjet pyetjeve të kandidatëve që kanë të bëjnë me udhëzimet.
- Shpërndarja e testit, plikove dhe materialeve shtesë bëhen sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit të sallës.

- Nuk lejohet shkrimi i emrit të kandidatit, shkrimi i numrave apo vendosja e ndonjë shenje tjetër dalluese në ndonjë prej fletëve të provimit. Në rast të veprimit të tillë, kandidati diskualifikohet.
- Kandidatët nuk lejohen të dalin nga salla e provimit gjatë kohës së provimit. Përfundimisht, ata lejohen të dalin, por të shoqëruar nga mbikëqyrësit e provimit, po ashtu edhe kur e përfundojnë pjesën përkatëse të provimit dhe e mbyllin atë në pliko.
- Kur të jepet shenja për përfundimin e provimit, kandidatët menjëherë vendosin testin në plikon e shpërndarë dhe e mbyllin atë. Në rast të kundërt, kandidati diskualifikohet nga provimi.
- Në fund të provimit, kandidatëve u shpërndahet një pliko e vogël brenda të cilës ka një letër të vulosur ku kandidati duhet të shkruaj emrin dhe mbiemrin e tij dhe pastaj e mbyllë atë. Pliko e vogël, së bashku me plikon e madhe, në të cilën ndodhet testi, merret nga sekretari në përfundim të provimit.
- Sekretari i Komisionit vendos një numër (kod sekret), i vulos ato dhe i vendosë në një pako të sigurt e cila gjithashtu vuloset.
- Në rast se kandidatët nuk i respektojnë këto rregulla, dhe gjatë provimit, mundohen të komunikojnë me të tjerët, do të përjashtohen nga provimi.